



1616/2 29.12.22

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Klokot-Vrbovc/Opština Klokot-Vrbovac

Datë: 27.12.2022

Në bazë të nenit 40.1 dhe 40.2(d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe Statutit të komunës nenit 13, pika 13.3(d), Kuvendi komunal i Klokotit në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit e mbajtur me datën 27.12.2022 bie:

VENDIM

MBI MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL KLOKOT-VËRBOVC PËR VITIN 2023

Neni 1

Në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit komunal të Klokot-Vërbovcit e mbajtur me datën 27.12.2022 delegatët kanë marrë vendimin: **Mbi Miratimin e planit të punës së kuvendit komunal të Klokot-Vërbovcit për vitin 2023.**

Neni 2

Në bazë të draft planit të punës së kuvendit nr.1586/2 të datës 15.12.2022 delegatët me votim të hapur me **14 vota për (1 delegat nuk ishte prezent)** vendosësi në nenin 1.

Neni 3

Plani i punës do të shërbejë si tregues i rendit të ditës për seancat e Kuvendit gjatë vitit 2023. Plani i punës së Kuvendit përmban orar për shqyrtimin dhe miratimin e vendimeve, urdhëresave komunale, raporteve dhe strategjive, si dhe shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit si dhe tema të tjera që do të jenë në agjendë gjatë vitit 2023.

Qëllimi i këtij dokumenti është përmirësimi i punës së Kuvendit të Komunës Klokot-Vërbovc dhe përmirësimi i funksionalitetit të tij.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kabineti i kryetarit të Komunës së Klokotit si dhe kryesuesi i Kuvendit komunal.

Neni 5

Ky vendim nga neni 1 hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës Klokot-Vërbovc dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga Ministria kompetente për Vetëqeverisje Lokale, dhe vlefshmëria e tij është deri në ndryshime apo plotësime të metutjeshme nga Kuvendi.

Kopja:

- MAPL
- Kabinetit kryetarit komës;
- Kryesuesi K.K Klokot-Vërbovc;
- Drejtorëve të drejtorive
- Arkivit komunës;



Kryesuesi i kuvendit komunal
Klokot-Vërbovc

/Milovan Bocić/